

Sipas autoritetit të dhënë nga Nenin 9 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në seancën publike të mbajtur më 15.12.2005 miratoi :

## **STATUTIN E ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGISË**

### **I. Kushtet e Përgjithshëm**

#### Neni 1

Statuti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (Statuti), përcakton strukturën e brendshme, organizimin, përfaqësimin, autoritetin dhe procesin e vendimmarrjes, rendin e aktivitetit, procedurën për punësimin e stafit, si dhe përgjegjësitë e stafit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”).

#### Neni 2

- 2.1. ZRRE-ja është autoritet i pavarur që bën rregullimin e sektorit të energjisë (Energjinë Elektrike, Ngrohjen Qendrore dhe Gazin Natyral) dhe është krijuar në pajtim me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 2.2. ZRRE-ja kryen aktivitetet e përcaktuara në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Ligjin mbi Energjinë, Ligjin mbi Energjinë Elektrike, si dhe me ligjet ose rregulloret e tjera, në një mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.
- 2.3. Në funksionimin e tij rregullativ, ZRRE-ja do të udhëhiqet me principet që janë të përshkuara në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë dhe Ligjin e Energjisë Elektrike.

### **II. Emri, Zyra e Regjistruar dhe Vula**

#### Neni 3

- 3.1. Emri i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në shqip është: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), në serbisht: Regulatorni Ured za Energiju (RUE). Përkthimi i emrit në anglisht do të jetë: Energy Regulatory Office (ERO).
- 3.2. ZRRE është një person juridik me zyrë të regjistruar në Prishtinë.

#### Neni 4

- 4.1 Në veprimtarinë e vet, ZRRE-ja do të përdorë vulën e vet zyrtare me emrin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Vula mundet të përfshijë edhe simbolin ose shenjën dalluese të ZRRE-së.
- 4.2 Vula do të mbahet nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së (“Kryesuesi”), ose ndonjë anëtar tjetër i ZRRE-së i autorizuar nga Kryesuesi.
- 4.3 Duke u referuar ne Nenin 4.2 përdorimi dhe llojet e vulave do të përcaktohen me një Vendim të posaçëm të përpiluar nga ZRRE.

### **III. Struktura Organizative e ZRRE-së**

#### **Neni 5**

- 5.1 ZRRE-ja do të ketë strukturën organizative që është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Statuti.
- 5.2 Bordi i ZRRE-së (“Bordi”) do të përbëhet nga pesë anëtarë- Rregullatorë. Në të ardhmen, numri i anëtarëve të stafit do të përcaktohet në bazë të ngarkesës së punës së ZRRE-së, sipas vendimit të Bordit.

#### **Neni 6**

- 6.1 Çdo Departament do të ketë një Kryesues të Departamenti i cili do të organizojë, kontrollojë, planifikojë, koordinojë, raportojë, vlerësojë stafin e tij/saj, dhe do të mbajë përgjegjësi për aktivitetet dhe përbushjen e detyrave që i janë caktuar stafit të Departamentit përkatës.
- 6.2 Departamenti dhe njësitë e tjera brenda ZRRE-së, mund të krijohen ose mbyllen, ose të ndryshojnë përgjegjësitë, vetëm me anë të vendimit të Bordit.
- 6.3 Në caktimin e të drejtave dhe përgjegjësive të anëtarëve të stafit, rregullat e brendshme dhe vendimet në lidhje me aktivitetet financiare ose administrative, por jo vetëm këto, mund të lëshohen nga Bordi i ZRRE.
- 6.4 Bordi mund të punësojë konsulentë ose këshilltarë të kualifikuar, për të ndihmuar ZRRE-në në ushtrimin e autoritetit, funksioneve dhe detyrave të saj.

### **IV. Bordi i ZRRE-së**

#### **Neni 7**

- 7.1 ZRRE-ja do të drejtohet nga Bordi i emëruar në pajtim me Nenin 5 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 7.2 Pas aprovimit nga ana e Bordit, Kryesuesi i Bordit mund t’u caktojë edhe detyra të tjera shtesë, autoritetin e zëvendësimit në vend të tij, si dhe përgjegjësinë e mbikëqyrjes së

departamenteve të veçanta, dhe/ose njësitë e ZRRE-së, që mund të kërkohen nga anëtarët tjerë të Bordit

- 7.3. Asnjë anëtar i Bordit nuk mund të ketë statusin e nëpunësit civil. Gjatë mandatit fillestar të gjithë anëtarët e Bordit do të nënshkruajnë kontratën e punës me ZRRE si personel profesional në fushën e përvojës së tyre të mëparshme.
- 7.4 Pas mandatit fillestar, tërë anëtarët e Bordit do të nënshkruajnë kontratën e punës si anëtarë të përhershëm të Bordit dhe kontrata do të zgjasë deri në fund të afatit të emërimit të tyre.

#### Neni 8

- 8.1. Mandati i anëtarëve të Bordit fillon nga dita e emërimit të tyre, siç është përcaktuar në Nenin 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 8.2. Secili anëtar i Bordit, duke përfshirë anëtarët fillestarë, mund të rizgjidhen për një mandat shtesë 5- vjeçar.
- 8.3. Kushtet për emërimin e Bordit janë të përcaktuara në Nenin 6 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 9

- 9.1. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (“PSSP”) gjatë mandatit fillestar, dhe Kuvendi pas mandatit fillestar, mund të shkarkojnë nga posti një anëtarë të Bordit para skadimit të mandatit të tij, vetëm në rastet e përcaktuara në Nenin 7 dhe 58.10 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 9.2. Gjatë mandatit fillestar, zbritja e mandatit fillestar ose shkarkimi i anëtarit të Bordit për shkak të ndonjë arsyeje të përcaktuar në Nenet 58.8 dhe 58.9 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, nuk do të konsiderohet si shkarkim i menjëhershëm prej ZRRE-së, por vetëm nga pozita e anëtarit të Bordit.
- 9.3. Duke iu referuar Nenit 9.2, Bordi mund të vendosë që:
  - a) Të përfundojë Kontratën e punësimit të ndonjë anëtari të Bordit; ose
  - b) T’i ofrojë atij ose asaj, një pozitë tjetër në ZRRE.

Vendimi duhet të bazohet në vlerësimin e përmbushjes së punës së çdo anëtari të Bordit, dhe do të arsyetohet siç duhet.

- 9.4. Gjatë mandatit fillestar, shkarkimi nga Bordi i ZRRE-së për shkaqe që përmenden në Nenin 7 (a) dhe (g) të Ligjit të Rregullatorit të Energjisë dhe 9.2 më lartë, nuk nënkupton automatikisht ndërprerjen e Kontratës së punës së anëtarit me ZRRE-në. Bordi i ZRRE do të vlerësoj arsyet për shkarkimin dhe mund t’i ofrojë anëtarit që të vazhdojë kontratën e tij të punës me ZRRE-në, apo mund të ndërpres Kontratën e punësimit.

## Neni 10

Bordi gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, do të:

- a) nxjerr dhe miratojë Statutin, Kodin e Etikës dhe Sjelljes, Rregullin mbi Liçencimin, Rregullin mbi Vënien e Çmimeve, Rregullin mbi Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, Rregullin mbi Çkyçjen, Pasqyrën e Taksave dhe Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji, rregulla, urdhra, akte dhe vendime të tjerë të lidhur me përgjegjësitë e ZRRE-së;
- b) merr pjesë aktivisht në mbledhjet që kanë të bëjnë me çështjet rregullative të energjisë në vendet e BE-së dhe në rajon, si dhe në komitete zhvillimore për promovimin e interesave të Kosovës,
- c) merr vendime për të dhënë, modifikuar, pezulluar, transferuar, përfunduar ose tërhequr licencat e ndërmarrjeve të energjisë, që dëshirojnë të merren me çdo lloj aktiviteti energjetik në Kosovë duke përfshirë edhe gjobat dhe dënime në përputhje me Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- d) merr vendimet në lidhje me aprovimin e tarifave dhe marrëveshjeve për blerjen e energjisë për veprimtaritë e rregulluara të energjisë;
- e) merr vendime në lidhje me lejet për ndërtimin e objekteve të reja në përputhje me Nenin 38.1 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe leje ose pëlqime të tjerë, si dhe kodet teknike ose operative të përcaktuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë;
- f) merr çdo vendim tjetër brenda kompetencave të veta, siç është përcaktuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

## Neni 11

Bordi do të organizojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e ZRRE-së, duke përfshirë:

- a) emërimin e menaxherëve dhe personelit të ZRRE-së;
- b) aprovimin e afateve dhe kushteve të punësimit për anëtarët e ZRRE-së; gjithashtu, sipas vendimit të Bordit, çdo anëtar i stafit mund t'i caktohen detyra dhe projekte "ad-hoc", edhe nëse kjo nuk është në shtrirjen e ngushtë të përgjegjësisë të postit të tij, në rast se e kërkon ngarkesa e punës në ZRRE, dhe në rast se Bordi mendon se ky anëtar i stafit i ka aftësitë dhe cilësitë për t'u marrë me detyrën që i është caktuar.
- c) përgatitjen e buxhetit dhe menaxhimin financiar të ZRRE-së;
- d) formulimin, miratimin dhe zbatimin e gjithë çështjeve të Legjislacionit Dytësor në formën e Kodeve, Rregullave, Dekreteve, Urdhresave ose urdhrave të përcaktuar me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, ose si të jetë nevoja, duke iu referuar mandatit të vet për rregullimin e sektorit të energjisë.

- e) të drejtojnë procedurat autorizuese dhe/ose tenderuese për ndërtimin e objekteve të reja energjetike.
- f) aktivitete tjera lidhur me ushtrimin e përgjegjësive të caktuara sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 12

Kryesuesi do të jetë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Bordit, dhe do të:

- a) thërres, caktojë rendin e ditës dhe kryesojë seancat e Bordit;
- b) përfaqësojë ZRRE-në përpara palëve të treta;
- c) bashkëpunojë me Institucionet Ndërkombëtare, Donatorët dhe Shoqatat Rregullatore në sektorin e energjisë;
- d) ndërmarrë të gjithë veprimet ligjore në emër të ZRRE-së dhe të përfaqësojë ZRRE-në në të gjitha seancat përpara Kuvendit, gjykatave, organeve administrative dhe trupa tjerë, si dhe me personat juridik publik;
- e) përmbushë kontrata dhe të aprovojë prokurim në emër të ZRRE-së;
- f) raportojë një herë një vit tek PSSP-ja dhe Kuvendi, gjatë mandatit fillestar dhe tek Kuvendi vetëm gjatë mandatit pasues, mbi punën e ZRRE-së, në përputhje me Nenin 10 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- g) kryejë detyrën e Kryeredaktorit të buletinit të ZRRE-së;
- h) kryejë detyra të tjera në përputhje me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, këtij Statuti dhe vendimeve të tjera të Bordit.

#### Neni 13

Duke u bazuar në Nenin 12, Kryesuesi do t'i propozojë Bordit:

- a) masat për mirëmbajtjen dhe gjetjen e investimeve, të nevojshme për veprimtarinë e ZRRE-së në mënyrë që të përmbushë si duhet detyrat e veta;
- b) masat për përmirësimin e punës dhe efikasitetit të ZRRE-së;
- c) masat dhe metodat për trajnime dhe zhvillimin e anëtarëve të stafit;

- d) zhvillimin dhe aprovimin e legjislacionit dytësor dhe akteve të tjera brenda kompetencave të veta;
- e) delegimin e disa detyrave tek anëtarët me më përvojë të ZRRE-së; dhe
- f) kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, delegimin e disa punëve profesionale tek këshilltarët e jashtëm, konsulentët, institucionet ose palët e treta.

#### **Neni 14**

Kryesuesi, në emër të Bordit, do të:

- a) lidhë, ndryshojë dhe ndërpresë kontratat e punës së anëtarëve të stafit, sipas vendimit të Bordit;
- b) miratojë pushimet (vjetore, mjekësore ose të tjera) të të gjithë anëtarëve të stafit;
- c) miratojë listën e personelit dhe të karakteristikave profesionale të punonjësve të administratës; dhe
- h) kryejë funksione të tjera që i janë caktuar atij me anë të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, këtij Statuti si dhe vendimeve specifike të Bordit.

#### **Neni 15**

- 16.5. Gjatë mungesës së tij, ose nëse është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, Kryesuesi mund të autorizojë një nga anëtarët e Bordit që ta përfaqësojë (zëvendësojë), ose të kryejë detyra specifike.

### **V. Seancat e Bordit**

#### **Neni 16**

- 16.1. Bordi do të takohet të paktën dhjetë (10) herë në vit. Kur nevojitet që të arrihen objektivat e ZRrE-së, Kryesuesi ose ndonjë anëtar tjetër i Bordit, mund të propozojë që Bordi të mbajë sesione shtesë.
- 16.2. Përveç sesioneve të rregullt, Bordi mund të mbajë edhe sesione të veçanta për çështje urgjente, për të cilat nevojiten sesione të ndarë.
- 16.3. Që të mbahet një sesion i Bordit, duhet që të jenë të pranishëm të paktën katër anëtarë të Bordit. Vendimet e Bordit do të merren me shumicën e thjeshtë të votave.
- 16.4. Duke iu referuar Nenit 25.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Kryesuesi i Bordit do të propozojë rendin e ditës së sesioneve të Bordit dhe do t'ua dorëzojë këtë rend dite anëtarëve të paktën pesë (5) ditë pune përpara çdo sesioni.

- 16.6. Pas konsultimit me Bordin, nëse kërkohet nga rrethana urgjente ose të shpejtësisë, Kryesuesi mund të bëjë ndryshime në rendin e ditës, të cilat nuk mund të adresohen për mbledhjen e ardhshme të Bordit.
- 16.7.
- 16.8. Kryesuesit e Departamenteve ose çdo anëtar i stafi mund të ftohet të marrë pjesë në një sesion të Bordit, në rast se kjo pjesëmarrje siguron kuptim ose shpjegim më të mirë të një rasti apo rrethane të rastit.
- 16.9. Bordi në sesionet e veta do të diskutojë të gjithë aplikimet, kërkesat, apelet dhe ankesat e marra, brenda kompetencave të veta, dhe do të diskutojë të gjithë çështjet që kanë të bëjnë me aprovimin e tarifave, ndryshimi ose shfuqizimi të legjislacionit dytësor, ose akteve, brenda kompetencave të veta.
- 16.10. Sesionet e Bordit janë të hapura për publikun, përveç sipas dispozitës së Nenit 18.1 në lidhje me diskutimin e informatave konfidenciale. .
- 16.11. Përpara votimit të ndonjë pike në program, Bordi do të lejojë komentet publike në çdo pikë të programit, siç është marrë parasysh. Përveç kësaj, në rendin e ditës së mbledhjeve të Bordit, do të përfshihet një periudhë për mundësinë e komenteve publike të përgjithshme, përveç në rastet kur mbledhja mbahet për qëllime të kufizuara dhe komentimi jashtë kësaj fushe të kufizuar është i ndaluar veçanërisht.
- 16.12. Mbledhjet e Bordit për diskutimin dhe përcaktimin e çështjeve administrative në lidhje me organizimin dhe mbikëqyrjen e ZRRE-së nuk i nënshtrohen kritereve të Nenit 16 dhe 18.

## **Neni 17**

- 17.1. Bordi do të krijojë dhe do të mirëmbajë një regjistër të palëve që kërkojnë njoftim për mbledhjet e Bordit, aplikimet e tarifave, iniciativat e Bordit për shqyrtimin e çmimeve, dhe çdo aktivitet tjetër specifik të Bordit. Çdo person, organizatë ose ndërmarrje mund të kërkojë përfshirjen në listë. Bordi do të sigurojë njoftimin e kërkuar për palët, në listën e regjistrimit të mbajtur, me anë të adresës elektronike, telefonit, postës ose faksit.
- 17.2. Njoftimi për mbledhjet e Bordit është i domosdoshëm të paktën (4) ditë përpara mbledhjes. Njoftimi do të përfshijë mënyrat vijuese:
- Publikimi i një njoftimi për mbledhjen e ZRRE-së në adresën zyrtare elektronike,
  - Dhënia e një njoftimi për shtyp ose njoftimi për shërbim publik për datën dhe rendin e ditës së mbledhjes, tek redaktorët e lajmeve në çdo gazetë, televizion dhe radio stacion në juridiksionin e vet.
  - Njoftim i palëve në regjistrin e mbajtur nga Bordi, me anë të postës elektronike, nëse është e mundur.

Kur ZRRE e sheh të arsyeshme, njoftimi mund të përfshij reklamën e paguara dhe të shtypura qartë dhe lexueshëm në gazetata kryesore ditore që qarkullojnë në tërë Kosovën.

- 17.3. Bordi do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar palët në regjistër që nuk kanë adresë elektronike për njoftim, sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi të jetë përcaktuar rendi i ditës dhe jo më vonë se 24 orë përpara mbledhjes.
- 17.4. Në rast të një ndryshimi në rendi i ditës pas njoftimit fillestar sipas Nenit 17.2, rendi i ditës duhet të publikohet menjëherë në adresën zyrtare elektronike të ZRRE-së dhe me anë të adresës elektronike tek palët që kanë dhënë adresat e tyre elektronike. Përpara mbledhjes, Bordi do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar mediat dhe ndonjë palë tjetër të interesuar për ndryshimin në rendin e ditës.
- 17.5. Njoftimi i mbledhjeve të Bordit do të përfshijë kohën dhe vendin e mbledhjes dhe një përshkrim ose përmbledhje të rendit të ditës. Nëse është e mundur, njoftimi do të identifikojë dokumentet përkatës të mbajtura ose të pranuar nga Bordi dhe që janë në dispozicion për shqyrtim publik.

### **Neni 18**

- 18.1. Sesionet e Bordit janë të hapura për publikun, përveç për pjesën e mbledhjes ku diskutohet materiali që mendohet si i fshehtë nga Bordi, në përputhje me procedurat e pranuar nga Bordi, sipas Nenit 19 të Ligjit mbi Energjinë. Në të tilla raste, vetëm ata persona që janë të vërtetuar nga Bordi për të pasur qasje në informacionet e fshehta në diskutim e sipër, mund të ndjekin atë pjesë të mbledhjes ku diskutohen informata konfidenciale.
- 18.2. ZRRE-ja në përputhje me kushtet e Kodit të Sjelljes dhe Etikës, vendos kriteret për të përcaktuar fshehtësinë e informacionit dhe masat për mbrojtjen e kësaj fshehtësie.
- 18.3. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit, si dhe anëtarët e stafit që kanë qasje në informacione të fshehta, janë përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë së informacioneve.

### **Neni 19**

- 19.1. Kryesuesi i Bordit do të caktojë një anëtar të stafit si Sekretar të Bordit, për të marrë pjesë në takimet e Bordit. Sekretari i Bordit nuk do të ketë drejt vote, dhe do të jetë përgjegjës për:
  - a) mbajtjen e shënimeve dhe/ose regjistrimin me zë ose video
  - b) përgatitjen e protokollit të sesionit dhe të bëjë qarkullimin për nënshkrim;
  - c) ftesën me shkrim për pjesëmarrësit;
  - d) njoftimin e sesionit në gazetatat ditore dhe media të tjera; dhe
  - e) njoftimin e sesionit në adresën zyrtare elektronike të ZRRE-së
- 19.2. Sesionet e Bordit do të fillojnë me një rishikim nga Kryesuesi i Bordit të protokollit të sesionit dhe procesverbalit të kaluar
- 19.3. Kryesuesi do të sigurojë një mundësi për të gjithë palët e interesuar, që të shprehin qëndrimin e tyre dhe të diskutojnë çështjet e shqetësimit.



## Neni 20

- 20.1. Anëtarët e Bordit do të përpiqen të jenë të pranishëm në të gjithë sesionet e Bordit. Një anëtar i Bordit mund të mungojë prej sesioneve vetëm në rrethanat e mëposhtme:
- a) udhëtim zyrtar;
  - b) pushim i lejuar ose sëmundje e verifikuar; ose
  - c) detyrë zyrtare urgjente.
- 20.2. Dokumentet që vërtetojnë arsyen e mungesës, do të bashkëngjiten në procesverbalin e sesionit përkatës.

## Neni 21

- 21.1. Bordi do të marrë vendime prej një shumice të thjeshtë të votave. Asnjë nga anëtarët e pranishëm të Bordit nuk mund të abstenojnë prej votimit përveç në rrethana të kufizuara, përfshirë konfliktin e interesit. Kur asi rrethanash ekzistojnë dhe abstenimi përfshinë anëtarin e Bordit, atëherë kërkohet regjistrimi i sqarimit mbi shkaqet e abstenimit të kërkuar.
- 21.2. Kryesuesi mund të kërkojë pëlqimin unanim për të kaluar një propozim ose për të marrë një vendim. Nëse nuk merret pëlqimi unanim, Kryesuesi do të thërrasë një votim të anëtarëve. Thirrja do të regjistrohet në protokollin zyrtar të mbledhjes.
- 21.3. Çdo anëtar mund të propozoj Bordit ndryshimin ose pranimin e një vendimi.
- 21.4. Në rast të numrit të njëjtë të votave, Kryesuesi do të ketë votën kryesore. Nëse Kryesuesi ka deleguar një anëtar tjetër të Bordit për të kryesuar në atë sesion, siç përcaktohet në nenin 15, anëtari kryesues i Bordit, do të ketë të njëjtat të drejta si edhe Kryesuesi, për të hedhur një votë vendimtare në rast të votimit të barabartë.
- 21.5. Ai anëtar i Bordit që nuk bie dakord me vendimin, mund të nënshkruajë protokollin e sesionit, me rezerva, me shpjegim të detajuar për arsyet e qëndrimit të tij mospajtues

## Neni 22

- 22.1. Në përfundim të mbledhjes, Kryesuesi do të mbyllë takimin dhe do t'i informojë palët e interesuara për datën dhe kohën e sesionit tjetër.
- 22.2. Kryesuesi, anëtarët e Bordit dhe Sekretari i Bordit do të nënshkruajnë protokollin e sesionit të Bordit, të paktën shtatë (7) ditë pas sesionit.
- 22.3. Protokollin e Mbledhjes do të përfshijë çështjet e diskutuara të programit, emrat e palëve të pranishëm në sesion, deklaratat e anëtarëve të Bordit dhe palëve të tjera, dokumentet e prezantuara, dhe përfundimet ose vendimet e marra.

## Neni 23

Në rast të një ankese formale, vendimi i Bordit të ZRRE-së do të përgatitet dhe dorëzohet tek aplikuesi ose palët e interesuara, brenda shtatë (7) ditëve prej datës së nënshkrimit të protokollit, siç përcaktohet në Nenin 22.2.

## **VI. Kontratat e Anëtarëve të Stafit**

### Neni 24

- 24.1. Fillimisht, të gjithë anëtarët e ZRRE-së do të kenë kontrata vjetore punësimi, të cilat do të rinovohen në fillim të çdo viti kalendarik, në varësi të vlerësimit vjetor të përmbushjes në detyrë.
- 24.2. Bordi, pas emërimit të tij, mund të vendosë të rrisë kohëzgjatjen e kontratës së punës të anëtarëve të stafit deri në dy (2) vjet.
- 24.3. Anëtarët e Bordit do të kenë kontrata pune në përputhje me mandatin e tyre, të përcaktuar në Nenin 5.3 dhe 5.4 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, dhe në lidhje me Letrën e Emërimit të nënshkruar nga autoriteti që ika emëruar.
- 24.4. Kur ZRRE-ja do të fillojë të prodhojë të ardhura dhe do të ketë buxhetin e vet, kushtet dhe parakushtet e kontratave të punësimit të stafit, do të aprovohen nga Bordi.

## **VII. Pagat e anëtarëve të stafit**

### Neni 25

- 25.1. Çdo anëtar i Bordit do të paguhet me një pagë mujore dhe ndihma të tjera financiare, në një shumë të përcaktuar prej PSSP-së, për anëtarët fillestarë, dhe prej Kuvendit për anëtarët e më pasmë.
- 25.2. Paga mujore për një anëtar Bordi, që është banor i përhershëm i Kosovës, do të jetë jo më pak se pesë (5) paga mesatare mujore të një zyrtari të sektorit publik të nivelit krahasues.
- 25.3. Paga mujore për një anëtar ndërkombëtar të Bordit do të përcaktohet nga PSSP-ja, bazuar në përvojën e tij/saj, përgjegjësitë e pozicionit dhe fondet në dispozicion.
- 25.4. Pagat mujore për anëtarët e tjerë të stafit të ZRRE-së që paguhet prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës ("BKK), do të bëhen konkurruese me pagat për pozicionet e njëjta në ndërmarrjet publike të rregulluara.
- 25.5. Këshilltarët ose konsulentët e ZRRE-së mund të jenë punësuar prej donatorëve ose ZRRE-së. Nëse punësohen prej donatorëve, paga përcaktohet dhe paguhet prej

donatorëve. Nëse punësohen prej ZRRE-së, kjo e fundit paguan pagën në bazë të kontratës së hartuar prej zyrës financiare së ZRRE-së.

- 25.6. Kur ZRRE-ja do të fillojë të krijojë të ardhura dhe të ketë buxhetin e vet, pagat e anëtarëve të stafit do t'i nënshtrohen hartimit të pagave të aprovuara nga Bordi.

### **VIII. Financimi i ZRRE-së**

#### Neni 26

- 26.1. Aktivitetet e ZRRE-së financohen në përputhje me Nenin 19 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 26.2. Fondet e ZRRE-së do të përdoren në përputhje me Nenet 20 dhe 21 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 27

- 27.1. Fondet e ZRRE-së do të mbahen në llogari bankare të veçanta.
- 27.2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të caktojë një auditor të jashtëm të kualifikuar për të revizionuar llogaritë dhe aktivitetet e ZRRE-së.
- 27.3. Kryesuesi ka autoritetin nënshkrues dhe mbikëqyrës mbi përdorimin e fondeve, së bashku me anëtar/ët e autorizuar të stafit, prej njësive së Financave dhe Prokurimit.
- 27.4. ZRRE-ja mban regjistrat e biznesit në përputhje me ligjet dhe rregulloret, të cilat përcaktojnë procedurën e kontabilitetit në Kosovë.

#### Neni 28

Kjo rregullore do të nxirret në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, do të zotërojnë versionin anglisht.

### **IX. Botimi i vendimeve dhe aktiviteteve të ZRRE-së**

#### Neni 29

- 29.1. ZRRE-ja publikon buletin çdo gjashtë (6) muaj.
- 29.2. Buletini do të përmbajë: aktet individuale dhe vendimet e tjera lidhur me licencat, por jo të kufizuar vetëm për licencat, lejet, dhe tarifatat të cilat do të paraqiten në formë të përmbledhjes.
- 29.3. ZRRE-ja do të publikoj raportin e vet vjetor në Buletin, pas aprovimit të tij fillimisht nga PSSP-ja, dhe më pas nga Kuvendi, pas periudhës fillestare.
- 29.4. Buletini do të aprovohet nga Bordi.

- 29.5. Bordi do të përgatisë dhe publikojë një regjistër me shkrim të vendimeve të veta, me të paktën elementët vijues:
- a) aktet e përgjithshme që përshkruajnë rregulla për aktivitetet rregulluese në sektorin e energjisë
  - b) akte individuale, përfshirë vendimet në lidhje me licencat dhe tarifat
  - c) vendimet që përfshijnë mosmarrëveshjet, sipas Nenit 17 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 29.6 Të gjithë vendimet e përgjithshme ose individuale të Bordit të ZRRE-së do të përfshijnë përshkrimet e detajuara të arsyeve të nxjerrjes së vendimeve.
- 29.7 Duke iu referuar Nenit 29.3 dhe 29.5, publikimi do të përfshijë edhe si vijon:
- a) Dhënien e një njoftimi për shtyp ose njoftimi për shërbim publik të datës dhe programit të mbledhjes, tek redaktorët e lajmeve në çdo gazetë, televizion dhe radio stacion në juridiksionin e vet, për sa i përket vendimeve në 29.5 a) dhe 29.5 b).
  - b) Qarkullimin e kopjeve tek të gjitha palët që marrin pjesë në ndonjë proces të ngjashëm konsultues
- 29.8 Kopjet e njoftimeve të cekura më sipër, do të mbahen në zyrat e ZRRE-së dhe do të vihen në dispozicion të publikut për inspektim ose kopjim, sipas kërkesës. Bordi i ZRRE-së mund të miratoj një çmimore për kopjim të dokumenteve me madhësi të specifikuar, në rast se kostot nuk janë mbi kostot reale dhe nuk përbëjnë një pengesë të papërshtatshme për qasjen publike në regjistra.
- 29.9 Aktet e përgjithshëm të ZRRE-së do të botohen në Gazetën Zyrtare dhe në adresën zyrtare elektronike të ZRRE-së.
- 29.10 Nëse Bordi ka nxjerrë një vendim individual, palët e interesuara (ose përfaqësuesit e tyre të caktuar), do të nënshkruajnë pranimin e vendimit.
- 29.11 Bordi garanton publicitetin e punës nëpërmjet sesioneve të hapura të Bordit, bashkëpunimit me mediat publike, botimit të raporteve vjetore dhe organizimit të konferencave për shtyp.

## **X. Ndryshimi i Statutit**

### Neni 30

- 30.1. Propozimi për ndryshimin e Statutit mund të bëhet nga cilido anëtar i Bordit dhe do të aprovohet nga Bordi.
- 30.2. Procedura për aprovimin e ndryshimeve të Statutit, do të jetë e njëjta procedurë si për miratimin e Statutit.

### **Neni 31**

Në rast se ka pika të paqarta dhe mosmarrëveshje në kushtet e këtij Statuti, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

### **XI. Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

### **Neni 32**

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Bordi dhe publikimit të tij në adresën elektronike të ZRRE-së.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

---

Anëtarët e Bordit:

---

---

---

---

# Shtojcë Nr. 1

## Struktura Organizative e ZRRE

**ERO Staff Number**  
 Current: 24  
 Planned this year: 26\*

